

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 5404/Prot.

Tiranë, më 14.10.2022

VENDIM

Nr. 426, datë 14.10.2022

PËR

MIRATIMIN E LISTAVE TIP ME AFATET E RUAJTJES SË DOKUMENTEVE
GJYQËSORE QË ARKIVOHEN NË GJYKATA

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenin 61, pika 1, shkronja 'd', nenin 90 pika 1, shkronja 'gj' dhe neni 97, pika 1, shkronja 'c', të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe në nenin 36 dhe nenin 48, të Ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe neni 7 të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Miratimin e "Listave tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata" sipas anekseve bashkëngjitur, pjesë e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KRYETARE

NAUREDA LEÇAMI



Listat tip të dokumenteve gjyqësore që arkivohen nga gjykatat

ANEKS 1 : DOSJET E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE CIVILE

Vendimet gjyqësore kanë afat ruajtje të përhershëm dhe nuk janë pjesë e dosjes për asgjësim.

Nr. i Serisë	Titulli i Serisë së Dosjes	Periudha e Ruajtjes
1-001	Trashëgimia	Përhershëm
1-002	Atësia	Përhershëm
1-003	Birësimi	Përhershëm
1-004	Padi pronësie	Përhershëm
1-004	Padi uzufukti	Përhershëm
1-004	Padi servituti kalimi	Përhershëm
1-004	Padi kërkim sendi	Përhershëm
1-004	Padi posedimore	Përhershëm
1-004	Padi trashëgimie	Përhershëm
1-004	Padi shkaktim dëmi	Përhershëm
1-004	Padi begatimi pa shkak	Përhershëm
1-004	Padi pagim i padetyruar	Përhershëm
1-004	Padi gjerim i punëve të tjetrit	Përhershëm
1-004	Padi kontratave të shitjes	Përhershëm



Nr. i Serisë	Titulli i Serisë së Dosjes	Periudha e Ruajtjes
1-004	Padi pjesëtimi pasurie	Përhershëm
1-005	Padi kontraktuale të tjera.	15 vjet
1-005	Të gjitha çështjet e tjera civile	15 vjet
1-005	Çështje familjare (zgjidhje martese)	10 vjet
1-006	Padi kundërshtim veprime përmbarimore	10 vjet
1-006	Çështje të pushuara	10 vjet
1-006	Kërkesa për dhënie autorizimesh	5 vjet
1-006	Kërkesa civile	5 vjet
1-006	Kërkesa për lëshim urdhër ekzekutimi	5 vjet
1-005	Lëshim i Urdhrit të Mbrojtjes	5 vjet
1-006	Ndreqje gabimi/interpretim	I bashkohet themelit, sipas objektit të padisë
1-006	Kërkesa të ndryshme	Sipas objektit të padisë
1-00x	Njohja e Vendimeve Civile të Huaja	Sipas natyrës së vendimit që njihet
1-00x	Rishikim Vendimi	Sipas objektit të padisë
3-001	Shfuqizim vendimi/ anulim vendimi, akti administrativ (ATP)	Përhershëm



ANEKS 2: DOSJET E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE PENALE

Vendimet gjyqësore kanë afat ruajtje të përhershëm dhe nuk janë pjesë e dosjes për asgjësim.

Nr. i Serisë	Titulli i Serisë së Dosjes	Periudha e Ruajtjes
2-001	Çështje penale ku është dhënë dënimi i përhershëm	Përhershëm
2-001	Çështje penale që për shkak të specifikës paraqesin rëndësi historike kombëtare (pavarësisht nga masa e dënimit të dhënë në vendimin gjyqësor)	Përhershëm
2-001	Çështje penale për krime kundër shtetit	Përhershëm
2-001	Çështje penale për krime kundër njerëzimit	Përhershëm
2-001	Çështje penale që lidhen me akte terroriste	Përhershëm
2-001	Çështje penale ku subjekt i veprës penale janë funksionarë të lartë të shtetit, funksionarë të sistemit gjyqësor, të zgjedhur vendorë, nëpunës publike vendas dhe të huaj, persona që ushtrojnë funksione publike.	Përhershëm
2-001	Çështje penale që kanë të bëjnë me pavarësinë dhe rendin kushtetues, sekretin shtetëror.	Përhershëm
2-002	Çështjet penale mbi të cilat është dhënë dënimi maksimal me burgim mbi 20 vjet deri në 30 vjet	40 vjet
2-003	Çështjet penale mbi të cilat është dhënë dënimi maksimal me burgim mbi 10 vjet deri në 20 vjet	30 vjet
2-004	Çështjet penale mbi të cilat është dhënë dënimi maksimal me burgim mbi 5 vjet deri në 10 vjet	20 vjet
2-005	Çështje penale në të cilat është dhënë dënimi maksimal me burgim deri në 5 vjet	15 vjet
2-005	Çështje penale në të cilat është dhënë dënimi maksimal me burgim deri në 5 vjet dhe me gjobë	15 vjet
2-005	Çështje penale në të cilat është dhënë dënimi me gjobë	10 vjet
2-005	Çështje penale në të cilat është dhënë pafajësi.	10 vjet
2-005	Çështje penale në të cilat është vendosur pushimi i çështjes.	10 vjet
2-005	Çështje penale në të cilat është vendosur zëvendësimi i dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit.	10 vjet
	Çështje penale me të mitur	25 vjet
2-006	Kërkesa penale	
2-006	Ulje dënimi	5 vjet
2-006	Konvertim dënimi	5 vjet
2-006	Ekzekutim letërporosie	5 vjet



2-006	Ndreqje gabimi	5 vjet
2-006	Kundërshtim i vendimi të prokurorisë	5 vjet
2-006	Rekomandim, kërkesa mase mjekësore	Përhershëm
2-006	Rivendosja e afatit të ankimit	5 vjet
2-006	Mosdhënie e mjeteve për jetesë	5 vjet
2-006	Ankim kundër procedimit penal	5 vjet
2-006	Ekstradim	5 vjet
2-006	Pezullim vendimi	5 vjet
2-006	Dhënie amnistie	5 vjet
2-007	Kundravajtje penale për të cilat është dhënë dënimi me burgim	5 vjet
2-008	Kundravajtje penale për të cilat është dhënë dënimi me gjobë	3 vjet
2-00x	Masave të sigurimit	5 vjet
2-009	Rishikim vendimi	Sipas objektit të padisë



ANEKS 3: DOSJET E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE ADMINISTRATIVE

Vendimet gjyqësore kanë afat ruajtje të përhershëm dhe nuk janë pjesë e dosjes për asgjësim.

Nr. i Serisë	Titulli i Serisë së Dosjes	Periudha Ruajtjes e
3-001	Çështje administrative që lidhen me të drejtën e pronës	Përhershëm
3-002	Çështjet administrative në fushën e marrëdhënieve të punës	10 vjet
3-003	Çështje administrative për kundërshtimin / anulim / shfuqizim akti/vendim administrativ	10 vjet
3-004	Çështje administrative për pavlefshmëri akti vendimi administrative	10 vjet
3-005	Çështje administrative për kundërshtim të veprimeve përmbartimore	10 vjet
3-006	Çështje administrative për kompesim burgimi të padrejtë	10 vjet
3-007	Çështje administrative që lidhen me vërtetimin e faktit juridik për elementë të gjendjes civile	10 vjet
5-001	Çështjet e Komisionit Zgjedhor — Nivel Kombëtar dhe Vendor	10 vjet



**ANEKS 4: DOSJET E ÇËSHTJEVE GYQËSORE
TREGTARE**

Vendimet gjyqësore kanë afat ruajtje të përhershëm dhe nuk janë pjesë e dosjes për asgjësim.

Nr. i Serisë	Titulli i Serisë së Dosjes	Periudha e Ruajtjes
4-001	Kërkesë për deklaram të falimentimit	15 vjet
4-001	Padi për anulim shoqërie	15 vjet
4-001	Padi shlyerje dëmi të administratorit	15 vjet
4-001	Padi për përgjegjësi të Këshillit Mbikëqyrës	15 vjet
4-001	Padi për tejkalim kompetencash administrative	15 vjet
4-001	Padi për mbrojtjen e pronësisë intelektuale/industriale	Përhershëm
4-002	Të tjera	5 vjet



ANEKS 5: DOSJET E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË GJYKATËS SË APELIT TË DEPOZITUARA NË GJYKATËN E SHKALLËS SE PARË

Vendimet gjyqësore kanë afat ruajtje të përhershëm dhe nuk janë pjesë e dosjes për asgjësim.

Nr. i Serisë	Titulli i Serisë së Dosjes	Periudha e Ruajtjes
5-001	Çështjet e Komisionit Zgjedhor — Nivel Kombëtar dhe Vendor	10 vjet
5-002	Njohja e vendimeve të gjykatave të huaja	Ruhen për të njëjtën kohë si çështjet me të njëjtin objekt padie
5-003	Urdhër ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Apelit	5 vjet
5-003	Ndreqje gabimi/ sqarim/ interpretim	I bashkohet themelit, sipas objektit të padisë
5-003	Kërkesa për konstatimin e shqyrtimit përtej afatit të arsyeshëm ligjor.	5 vjet



ANEKS 6 DOSJET E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Dosjet e menaxhimit të çështjeve përdoren për të skeduar veprimet e regjistrimit, të përkohshëm dhe përfundimtar në lidhje me çështjen, për të informuar avokatët, publikun dhe agjencitë shtetërore për paraqitjet në afatin e caktuar dhe për çështje të tjera lidhur me administratën gjyqësore, si dhe për të ruajtur regjistrat e individëve apo subjekteve ligjore që mund të përfshihen në procedimin e çështjeve:

Nr. i Serisë	Titulli i Serisë së Dosjes	Periudha e Ruajtjes
6-001	Regjistrat dhe Indekset përfshirë:	Përhershëm
	Regjistri Themeltar Civil	
	Treguesi Alfabetik i Çështjeve Civile	
	Regjistri i Vendimeve Civile	
	Regjistri i personave që u është hequr, kufizuar, ose kthyer zotësia për të vepruar	
	Regjistri i Çështjeve Civile të Ankimuarra /Rekurse	
	Regjistri i Vëllimit të Vendimeve Civile	
	Regjistri i Kompanive Tregtare	
	Regjistri i Personave Fizikë	
	Regjistri i Organizatave Jo-Qeveritare	
	Regjistri i Partive Politike	
	Regjistri i Ndërmarrjeve Shtetërore	
	Regjistri i Çështjeve Speciale Civile dhe Penale	
	Regjistri i Provave Materiale	
	Regjistri Themeltar Penal	
	Regjistri Penal Ushtarak	
	Treguesi Alfabetik i Çështjeve Penale	
	Regjistri i Vendimeve Penale	
	Regjistri i Çështjeve të Ankimuarra Penale/Rekurse	
	Regjistri i Lirimit me Kusht, i Revokimit të Vendimeve, i Njohjes së Vendimeve të Gjykatave të Huaja	
	Regjistri i Masave të Sigurisë	
	Regjistri i Vëllimit të Vendimeve Penale	
	Regjistri i të Miturve	
6-002	Dokumente të çështjes dhe të administratës së gjykatës, si letra drejtuar avokatëve, institucioneve	10 vjet



6-003	Të dhëna statistikore dhe analiza vjetore të gjykatës	10 vjet
6-004	Raporte statistikore vjetore	Përherëshëm
6-005	Akte administrative të lëshuara nga institucione të tjera që nuk kanë lidhje me shqyrtimin e çështjeve gjyqësore konkrete	10 vjet

SECRETARIA



ANEKS 7 : DOSJET E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE QË GJYKOHEN NGA GJYKATAT E POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Vendimet gjyqësore kanë afat ruajtje të përhershëm dhe nuk janë pjesë e dosjes për asgjësim.

Nr. i Serisë	Titulli i Serisë së Dosjes	Periudha e Ruajtjes
	Dosje penale themeli	Përhershëm
	Dosje penale seanca paraprake	Përhershëm
	Dosjet e masave të sigurimit	10 vjet
	Dosjet e kërkesave për përgjim	5-10 vjet
	Dosjet e kërkesave me objekt: sekuestrim dhe konfiskim pasurie, sipas Ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”	20 vjet
	Dosjet e kërkesave me objekt: Sekuestrim dhe konfiskim pasurie sipas Aktit Normativ nr. 1, datë 31.1.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit të sigurisë publike”	20 vjet
	Dosjet e kërkesave penale	5-10 vjet
	Të gjitha dosjet e ish Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë	Përhershëm
	Vendime penale, sipas dosjeve	Përhershëm
	Regjistrat	
	Regjistri Themeltar i Çështjeve Penale Themeli	Përhershëm
	Numërori i Vendimeve të Çështjeve Penale të Themelit	
	Regjistri Themeltar i Seancave paraprake	
	Regjistri i Masave të Sigurimit	
	Regjistri Kërkesave Penale	
	Regjistri i Kërkesave për Përgjim	
	Regjistri i Kërkesave për Konfiskim Pasurie, sipas Aktit Normativ nr. 1, datë 31.1.2020“Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit të sigurisë publike”	
	Regjistri i Kërkesave me objekt: “Sekuestro/konfiskim Pasurie”	
	Numërori i vendimeve me objekt: “Sekuestro dhe konfiskim pasurie”	
	Indekset alfabetike, sipas regjistrave përkatës	
	Regjistri i të miturve	



	Regjistri për ankimet
	Regjistra protokolli të jashtëm
	Regjistra protokolli të brendshëm
	Regjistri i Urdhrave të Brendshëm
	Regjistrat e Arkivës të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, (si dhe ish Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë)

